



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

DIJETARI DHE ZULLUMQARI

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

PERSONAZHET KRYESORE.....	4
HYRJE.....	5
KUSH ËSHTË SEID BIN XHUBEJRI?.....	6
PJESA E PARË.....	8
(NJË AKTËSHE).....	8
PJESA E DYTË.....	27
(AKTI I PARË).....	27
(AKTI I DYTË).....	41
PJESA E TRETË.....	44
(AKTI I PARË).....	44
(AKTI I FUNDIT).....	72

PERSONAZHET KRYESORE

SEID BIN XHUBEJRI

HAXH-XHAXH ETH-THEKAFIU

PLAKU

THABITI

UMEJRI

POLICI

EBU HUSAJNI

AMIR ESH-SHA'BI

MATRAF BIN ABDULL-LLAHU

ROJTARI I BURGUT

DJALOSHI

HYRJE

Kjo dramë është e re dhe e vjetër. E re për nga forma kurse e vjetër për nga teksti. E kam shkruar para 17 vjetësh dhe me ndihmën e All-llahut iu prezentua masës. Suksesit nuk mungoi dhe pati jehonë të madhe. Më vonë ky tekst më humbi dhe assesit nuk mund ta gjeja.

Ky hall kthen kujtesën time në vitin 1949. Në atë kohë isha në mesin e studentëve që i rrëmbyen “qentë e gjuetisë”. Ata na hodhën pas grilave të burgjeve të Hekstejit dhe kodrave të Turit të këtij dheu egjiptas. Na rrëmbyen vetëm pse ne thirrnim në Islamin e vërtetë.

Në burgun e Hekstejit që e rrethonte shkretëtira e Saharasë, lexoja literaturë me përmbajtje letrare dhe historike. Nga kjo literaturë përshtypje të thellë më la personaliteti i Seid bin Xhubejrit dhe qëndrimi i këtij dijetari, fakihu dhe trimi ndaj zullumqarit dhe diktatorit Haxh-xhaxh bin Jusuf Thekafit.

Kaherë më pat tërhequr drama si gjini letrare, kështu që derisa isha nxënës i vitit të parë në gjimnaz, pata përpiluar një dramë poetike me titull “Jusufi i drejtë”. Me këtë rast ngjarjen e Seidit me Haxh-xhaxhin e pashë të përshtatshme që ta shkruaj si dramë. Kjo dramë do ta arrinte qëllimin dhe do ta kryente misionin e vet, posaçërisht kur ne i luftonim diktatorët që ishin më të rrezikshëm se Haxh-xhaxhi. Dramën e shkruajta dhe ajo u ekzekutua nga të burgosurit në burgun e kodrave të Turit. Por, më vonë ky tekst humbi.

Dhe ja sot, historia e njëjtë po përsëritet kurse tiranët vazhdimisht po shtohen. Dhuna dhe presioni ndaj muslimanëve dita-ditës po rriten, dënimet po bëhen gjithnjë e më të ashpra kurse masat e represionit më të egra dhe tmerruese. Muslimanët e sotëm po i përjetojnë torturat me

metodat më të fëlliqura nga zullumqarët bashkëkohorë, të cilët me metodat e tyre të ushtrimit të dhunës janë më të rrezikshëm se Haxh-xhaxhi ndaj Seidit.

Situata e tendosur që po e përjetojmë sot, ma imponoi nevojën ta rishkruaj dramën e të kaluarës së afërt. Madje faktori i sotëm po ma bën të domosdoshme këtë punë. I inspiruar nga periudha e Tabi'inëve që ishte e pasur me figura heronjsh dhe qëndrime të shkëlqyeshme, krahas diktatorëve dhe dhunës së tyre me të cilën e tmerruan këtë periudhë, kjo dramë le të jetë shembull për muxhahidinët e sotëm anekënd vatanit islam. Ne mund të qëndrojmë e të përballojmë vetëm nëse jemi të udhëzuar me personalitetin e Seid bin Xhubejrit, përplot iman, dije, trimëri e qëndrueshmëri që librat e letërsisë, historisë, biografive të heronjve i ruajtën për gjeneratat tona.

KUSH ËSHTË SEID BIN XHUBEJRI?

Ai është njëri nga imamët e kohës së Tabi'inëve. Në atë kohë Ibn Abbasi ishte pena e ummetit. Kur banorët e Kufes e pyetnin për ndonjë çështje fetare, ai përgjigjej në këtë mënyrë: “A mua më pyetni kur në mesin tuaj gjendet Seid bin Xhubejri?!”. Me rastin e vdekjes së tij, Ahmed bin Hanbeli tha: “Seid bin Xhubejrin e mbytën pikërisht atëherë kur çdo musliman në sipërfaqe të tokës kishte nevojë të madhe për dijen e tij”.

Kështu Seidi si çdo fakih refuzoi sjelljen e Haxh-xhaxhit me popullin, i cili u ngrit në këtë pozitë të lartë udhëheqëse pa të drejtë dhe pa meritë, ngase i shtypte muslimanët, derdhte gjakun e tyre, varroste liritë dhe i keqpërdorte autoritetet e tyre.

I shtyer nga kjo gjendje e mjerueshme, Abdurr-rahman Ibni Esh'ath El Kisi, komandant i stërvitur dhe trim, shpalli luftë kundër Haxh-xhaxhit dhe Beni Umejjeve. Ushtria e tij përparonte në Irak. Atij iu bashkangjitën shumica e dijetarëve dhe fetarëve, e në ballë të tyre qëndronin Seid bin Xhubejri, Amir Esh-sha'bi dhe Matraf bin Abdull-llah bin Shehir.

Midis ushtrisë së Ibni Esh'athit dhe të Haxh-xhaxhit u zhvilluan beteja të shumta. Në fillim të përleshjeve ai fitoi i pari, por Haxh-xhaxhi me strategjinë dhe guximin e tij arriti ta shpartallojë ushtrinë e Ibni Esh'athit dhe i shkaktoi humbje bindëse në betejën e njohur me emrin “Dejru-l-xhemaxhim”. Pas kësaj humbjeje disa u vranë, disa u robëruan e disa ikën dhe shpëtuan. Në mesin e atyre që arritën të shpëtojnë ishin edhe Ibni Esh'athi dhe Seid bin Xhubejri.

Sipas parimeve islame (dispozitave të Sheriatit), të ikurit që humbin luftën lihen të lirë dhe nuk ndiqen, robërit nuk vriten kurse të plagosurit nuk torturohen, por mjerisht Haxh-xhaxhi nuk iu përmbajt këtyre parimeve. Ai vrau shumë prej robërve, të ikurit i ndiqte, i zinte dhe ua prente kokat. Kështu ai e ndoqi Seidin derisa e zuri, e kjo ndodhi trembëdhjetë vjet pas mbarimit të luftës. Edhe pas kësaj periudhe të gjatë, Haxh-xhaxhi nuk e amnistoi por me të veproi njëllëj si me bashkëluftëtarët e tij.

PJESA E PARË (NJË AKTËSHE)

Koha: Perandoria e Beni Umejjëve. Periudha e mbretërisë së Abdul Melik bin Mervanit.

Vendi: Vilajeti i Irakut që është nën mbikëqyrjen e Haxh-xhaxhit. Qyteti Vasis, midis Kufes dhe Basrës të cilin e zaptoi Haxh-xhaxhi.

Haxh-xhaxhi i ulur në fron të mexhllisit të vilajetit, arrogant dhe kryelartë. Rreth tij në këmbë qëndrojnë katër këshilltarët e tij dhe roja.

NJËRI PREJ TYRE

Urime o emir për këto fitore kundër armiqve tu dhe armiqve të mbretit.

I DYTI

I tërë Iraku po flet për ndihmën që ia dha All-llahu halifes përmes teje dhe për humbjen e kryefitnexhiut, Ibnul Esh'athit dhe bashkëluftëtarëve të tij.

I TRETË

Këta lakmues i krekosi butësia e mbretit dhe dashuria e tij ndaj popullit. Shfrytëzuan rastin dhe organizuan kryengritje të armatosur. Por tani e kuptuan se kush është Haxh-xhaxhi e kush janë ata.

HAXH-XHAXHI

(Arrogant dhe krenar) Ibni Esh'athi mendoj se me bashkangjitjen që ia bënë fukahatë si Seid bin Xhubejri, do ta fitojë betejën. Por mjerim për ta që harruan se shpata e Haxh-xhaxhit nuk thehet, ushtria e bijve të Mervanit nuk shkatërrohet, kurse “Dejrul Xhemaxhim” është argument bindës.

I KATËRTI

O emir, më informuan luftëtarët që ishin në “Dejrul Xhemaxhim” se shpatat tua e tmerruan Ibnul Esh'athin dhe shokët e tij. Kokat u fluturonin, gjymtyrët u copëtoheshin, e kur e panë humbjen disa u dorëzuan e disa ikën.

HAXH-XHAXHI

Po ata nuk morën mësim nga ajo që i ndodhi Abdull-llah bin Zubejrit dhe ushtrisë së tij prej dorës së Haxh-xhaxhit. Ja shihni, ky është përfundimi i tyre. Le ta ndezin zjarrin e fitnes sa të duan, dora e Haxh-xhaxhit do ta shuajë.

I TRETË

O emir, gabon nëse të kaplon butësia ndaj robërve të luftës. Ata u dorëzuan me dhunë. Në gjokset e tyre vlon urrejtja kundër teje dhe Beni Umejjëve. Mos i harro dijetarët që e përkrahën Ibnul Esh'athin dhe e ndihmuan me mish e me shpirt, e veçanërisht ai hoxha i quajtur Seid bin Xhubejr.

HAXH-XHAXHI

Ne për çështjen e tyre jemi duke pritur një përgjigje prej halifes. Kemi shpresa se do të arrijë sot.

I PARI

Halifja për ta do të flasë me shpatë, dënim për trazirat që i shkaktuan. Kush ngre shpatën kundër halifes, dënohet me të.

I DYTI

Të lumtë, se kryengritësi është zullumqari më i madh.

PORTIERI

Ja, arriti posta e halifes.

HAXH-XHAXHI

Atë ishim duke e pritur. Ma jep shkresën. (E nxjerr shkresën dhe e lexon me zë të lartë):

Shpëtimi qoftë me ty dhe me ata që i ke krahë.

Vendim:

Të gjithë ata që iu bashkangjitën kryengritjes së Ibnul Esh’athit në betejën “Dejrul xhemaxhim” uli para shpatës. Ai që pranon se ka bërë kufër liroje, e kush refuzon dhe supozon se është mu’min, merrja kokën.

HAXH-XHAXHI

(Portierit) Le të vijë shefi i policisë.

(Del portieri e fton dhe hyn bashkë me të).

SHEFI I POLICISË

Urdhëroni o emir!

HAXH-XHAXHI

Shko në burg te të burgosurit dhe pasi t'ua lexosh shkresën e halifes, sjelli këtu.

SHEFI I POLICISË

Me plot respekt, o emir!

(Del dhe pas disa çasteve hyn portieri)

PORTIERI

Në portë qëndron një plak i shtyrë në moshë, thotë se ka një nevojë.

HAXH-XHAXHI

Kthene prap. Nuk është sot dita për ankesa dhe nevojtarë.

PORTIERI

Policia e paska përgjakur. Qanë e dënes. Thotë: "Ose më vritni ose më lejoni të hyj te emiri".
Është plak i kërrusur me mjekër të bardhë.

HAXH-XHAXHI

Mirë, le të hyjë brenda.

(Hyn plaku, serioz)

PLAKU

Es-selamu alejkum o emir!

HAXH-XHAXHI

Ve alejkumus-selam. Ç'nevojë keni?

PLAKU

Birin tim e keni marrë tashmë një vit e tepër. As nuk e liruat e as nuk e gjykuat. Ka një nënë plakë që lotët nuk i ndalen për shkak të tij dhe një motër të vejë me tre fëmijë. Ai është i vetmi kujdestar i familjes, kurse ne pas All-llahut, vetëm në të kemi mbështetje.

HAXH-XHAXHI

(Me indiferencë) Po pse ne e mbajmë birin tënd?

PLAKU

(I hidhëruar dhe i pezmatuar) Si, njerëzit i burgosni dhe nuk e dini pse?!!

HAXH-XHAXHI

O plak, ka shumë të burgosur. Çdonjëri prej tyre ka krimin dhe akuzën e vet.

PLAKU

Biri im nuk ka bërë kurrfarë krimi. Problemi qëndron në atë se njërin prej farefisit tonë e akuzuan nëpunësit tuaj. Erdhën që ta marrin por nuk e gjetën. E atëherë, në vend të tij e morën birin tim.

HAXH-XHAXHI

Ndodh edhe kjo. Ndonjëherë edhe i shëndoshi shkon në vend të sëmurit. Nëse dëshiron të lirohet djali yt, sille të akuzuarin që iku. A nuk i ke dëgjuar fjalët e poetit:

Ndonjëherë pëson i zoti i shtëpisë

për gjynahet e familjes së tij

e shpëton, gjynahqari kriminel.

PLAKU

Por unë e kam dëgjuar All-llahun, e Ai e thotë të kundërtën.

HAXH-XHAXHI

E çka ka thënë?

PLAKU

All-llahu me gjuhën e Jusufit alejhis-selam thotë: “Na ruajt All-llahu ta marrim tjetrin pos atë te i cili e kemi gjetur sendin¹ tonë, Ne atëherë do të jemi të padrejtë”. Kujt t'i besojmë, fjalës së All-llahut apo të poetit?!

HAXH-XHAXHI

Më binde o plak. Të kota i bëre argumentet e mia. Lirone birin e tij.

NJËRI PREJ ROJES

Kjo është drejtësia. Rroftë emiri ynë i drejtë.

¹ Sendi (gota) u gjet në barrën e Bunjaminit. Jusufi refuzoi të merret ndonjë vëlla tjetër, edhe pse ata kërkuan një gjë të tillë

I DYTI

Emiri ynë qëndron korrekt ndaj Librit të All-llahut.

TJETRI

Emiri ynë nuk dëmton askënd, aspak.

(Del plaku dhe pas disa çasteve hyn portieri)

PORTIERI

Erdhi shefi i policisë. Me të janë edhe të akuzuarit.

HAXH-XHAXHI

Le të hyjnë një nga një.

(Hyn një burrë me rroba të kalorësit, ndërsa Haxh-xhaxhi shikon në të me përbuzje dhe ironi)

HAXH-XHAXHI

Sërish ti?! Në çdo trazirë të hasim. Dje ishe me Ibni Zubejrin, sot me Ibni Esh'athin. Nëse një trazirë shpërthen edhe në krahinat e Vakvakut,² do të isha unë shukës i asaj trazire. *(I drejtobet njeriut)* Ç'krim bëre ore munafik, i poshtër, i turpëruar?

² Vakvaku është krahinë në lindje të Kinës afër Oqeanit Indian

NJERIU

(Me këmbëngulje dhe vendosmëri) Pasha All-llahun nuk mposhtet ai që e do hakun, edhe nëse i vërsulet e tërë bota. Po as që ngrihet ai që e do batilin, edhe nëse nga gioksi i tij del hëna.

HAXH-XHAXHI

(Me kërcënim) Më vraftë All-llahu nëse nuk të vras ty.

NJERIU

Nëpunësi yt më ka dhënë garanci jetësore me besë dhe zotim në All-llahun.

HAXH-XHAXHI

Po vallë, mos e mbajte besën e All-llahut ndonjëherë që ta mbajmë edhe ne?

NJERIU

A don të më tradhtosh o Haxh-xhaxh, e ta nëpërkëmbish zotimin në All-llahun?

HAXH-XHAXHI

(Duke iu shmangur përgjigjes) Më trego, kush të shtyri të na kundërshtosh edhe kësaj here?

NJERIU

(Me vendosmëri) Ajo që më shtyri më parë do të më shtyjë gjithmonë. Ju e doni shtetin mbretëri e trashëgim, e ne e duam hilafet e konsultim, ju e doni shtetin me sistem romak ose persian, e ne e duam me sistem kur'anor dhe islam.

HAXH-XHAXHI

(Me nënçmim) Ti do të na e mësosh Islamin? Neve me të na u zbardhën mjekrat.

NJERIU

A mund ta arsyetojë dikush se derdhja e gjakut, keqpërdorimi i pasurive dhe frikësimi i muslimanëve nuk janë zullum i madh?! Apo mos vallë këto i përkrah Islami?!

HAXH-XHAXHI

Ne vetëm i bëjmë terbijë ata që shkaktojnë trazira si ti dhe e çrregullojnë rendin publik.

NJERIU

Po e zëmë se unë jam kryengritës. Po a thua u solle me ne ashtu siç e parasheh Kur'ani? Kryengritësit që ikin nga fusha e luftës nuk ndiqen, robërit nuk vriten, të plagosurit nuk torturohen e as pasuria nuk ju merret.

HAXH-XHAXHI

Ju nuk jeni vetëm kryengritës. Ju keni bërë kufër me shkeljen e besëlidhjes dhe kundërshtimin e halifes.

NJERIU

Ne luftuam shtypjen dhe tiraninë pasi që na lëshoi durimi. Ndërsa Ibnul Esh'athi nuk luftoi vet, por me të doli i gjithë populli i Irakut në ballë me dijetarët e tij. A mund të thuash se këta dijetarë janë kafirë dhe munafikë, kurse ti dhe ushtarët tu jeni besimtarë të sigurtë që kërkoni falje?!!

HAXH-XHAXHI

(I bidhëruar) Talleh me mua o i fëlliqtë? Shporreni dhe hiqjani kokën. *(Pastaj kthehet kah njeriu dhe i drejtohet me pëshpëritje)* Do të shohish se cili do të jetë i mbytur dhe i nënçmuar, ti apo unë.

NJERIU

Llogaris se ti o Haxh-xhaxh nuk do të vdesish i mbytur.

HAXH-XHAXHI

Pse ore falltor?

NJERIU

Sepse i kam dëgjuar dijetarët e mirë si Hasan Basriun dhe Seid bin Xhubejrin duke bërë lutje te All-llahu, që mos të ta marrë shpirtin në luftë por në shtratin tënd.

HAXH-XHAXHI

(I këndellur nga habia) Hasani dhe Seidi lusin All-llahun të vdes në shtrat?!

NJERIU

Po o Haxh-xhaxh, që ta ruajë All-llahu dënimin tënd krejtësisht për ahiret. E dihet se dënimi në ahiret është më i rëndë dhe më i vështirë.

HAXH-XHAXHI

(I shashtisur) Merrjani shpirtin të mallkuarit. Dorëztojani xhelatit.

NJËRI NGA ROJAT

E meriton.

I DYTË

Ky është dënimi më i lehtë që u takon njerëzve të tillë.

I TRETË

“Ndëshkimi i të keqes bëhet me të keqe në të njëjtën masë”

(Hyn njëri prej të akuzuarve, plak prej Beni Temimit e pas tij hyn edhe një i ri prej Beni Bekrit).

HAXH-XHAXHI

(Të riut) Besimtar je apo kafir?

I RIU

Si më do, kafir apo besimtar?

HAXH-XHAXHI

(Me këmbëngulje) S'ka vend për diskutim. Kafir je apo besimtar?

I RIU

Më mirë kafir.

HAXH-XHAXHI

(Me tallje) Por plaku i Temimit nuk pajtohet me kufër?

PLAKU

A do të më mashtrosh o Haxh-xhaxh, e të mos shpëtojë shpirti im? Pasha All-llahun, sikur të ketë diçka më e madhe se kufri do ta kisha pranuar, vetëm të shpëtoj nga shpata yte.

(Qesh Haxh-xhaxhi dhe urdhëron të lirohet. Pastaj ia paraqesin një njeri tjetër)

HAXH-XHAXHI

Në fenë e kujt je?

NJERIU

Në fenë e pastër të Ibrahimit që nuk ishte prej idhujtarëve.

HAXH-XHAXHI

Kokën këtij rrenacaku, me shpatë.

(Pastaj i paraqitet edhe një tjetër)

HAXH-XHAXHI

Në fenë e kujt je?

NJERIU

Në fenë e babait tënd Jusufit.

HAXH-XHAXHI

Ashtu pra, pasha All-llahun ishte burrë i vërtetë. Le të lirohet ky burrë, o djalosh.

(Djaloshi ia beq prangat, njeriu i afrohet Haxh-xhaxhit dhe i flet me seriozitet)

NJERIU

O Haxh-xhaxh, e pyete shokun tim për fenë e tij e ai t'u përgjigj se është në fenë e Ibrahimit. Ti urdhërove t'i pritet koka. Gjithashtu ma shtrove edhe mua të njëjtën pyetje e unë t'u përgjigja në fenë e babait tënd Jusufit. Ti ma ktheve: Ashtu pra, pasha All-llahun ishte burrë i vërtetë, dhe urdhërove të lirohem.

HAXH-XHAXHI

(Lëkund kokën) Po po, ashtu është.

NJERIU

Vall-llahi o Haxh-xhaxh, sikur babai yt të mos ketë bërë asnjë gjynah përveç atij që të ka lindë ty, do t'i mjaftonte kjo e keqe.

(Roja shikohet me habi mes vete)

HAXH-XHAXHI

(Me hidhërim dhe pezm) Mbyteni, mbyteni këtë fëlliqësirë të mallkuar!! Kokën edhe këtij!

(Pastaj hyn një djalosh. Në të shihen shenjat e mirësisë, e quanin Thabit)

NJËRI PREJ KËSHILLTARËVE

(Me pëshpëritje i flet Haxh-xhaxhit) Ky është njëri prej talebeve të Seid bin Xhubejrit.

HAXH-XHAXHI

A ti je talebe i hoxhës fitnexhi që i çoi njerëzit në dalalet?

THABITI

Jo.

HAXH-XHAXHI

A e mohon lidhjen me të?

THABITI

Hoxhën të cilin e përmendët nuk e njoh. Unë njoh hoxhën e ndershëm që i nxjerr njerëzit në dritë, Seid bin Xhubejrin, dijetar dhe muxhahid.

HAXH-XHAXHI

Ai i cili e kundërshtoi hilafetin dhe shkaktoi përçarje është i ndershëm, ore xhahil dhe munafik?!!

THABITI

Ata që kundërshtojnë fenë e All-llahut është detyrë e njerëzve t'i luftojnë. Ndërsa fitneja e vërtetë është shtypja e dijetarëve e besimtarëve dhe torturimi i tyre në mënyrë të padrejtë. A nuk e ke lexuar fjalën e All-llahut në Kur'an: “Pa dyshim, ata që i torturojnë besimtarët dhe besimtare të që (pastaj) nuk pendohen - i pret dënimi i skëterrës dhe dënimi i djegies”.

HAXH-XHAXHI

Kjo është dituri e Seid bin Xhubejrit?!

THABITI

Jo, por kjo është fjalë e All-llahut dhe fjalë e Pejgamberit.

HAXH-XHAXHI

Pasha atë i cili të ka krijuar, do t'ju korrë një nga një derisa të zhdukeni të gjithë.

THABITI

Ti korr, por All-llahu mbinë. A mund të krahasohet fuqia e krijesave me atë të Krijuesit?!

HAXH-XHAXHI

Mbytnë këtë dijetar të rrejshëm. (*Pastaj i kethebet Thabitit dhe i thotë me nënçmim*) Ndoshta hoxha yt i ndershëm që i nxjerr njerëzit në dritë, do të të ndihmojë sot?

THABITI

Ndihma dhe pengesa janë në duart e All-llahut. “Vetëm Atij i takojnë krijimi dhe sundimi”. Ne në këso ditë shpirtat tanë i qetësojmë. Po, sot po nënshkruhet kontrata nga dora yte o Haxh-xhaxh.

HAXH-XHAXHI

Çfarë kontrate ore xhahil dhe dijetar i rrejshëm?!

THABITI

Me emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit. “All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me xhennet”. Kjo është dita kur ti po e dorëzon mallin e ne po e japim çmimin... Xhennetin o Haxh-xhaxh, “E kush plotëson premtimin më mirë se All-llahu”.

HAXH-XHAXHI

Atje s’do të gjeshe asgjë përveç zjarrit. Merrne shpejt dhe hiqjani kokën.

THABITI

“Gjyko si të duash, ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote”.

(E çojnë Thabitin kab shpata)

HAXH-XHAXHI

Kush mbeti prej këtyre tradhtarëve?

SHEFI I POLICISË

Amir Esh-sha'biu dhe Matraf bin Abdull-llahu, ndërsa Seid bin Xhubejri iku dhe siç e dini është fshehur diku.

HAXH-XHAXHI

Si, nuk arritët ta zini Ibni Xhubejrin?!

SHEFI I POLICISË

All-llahu e forcoftë emirin tonë. Kufijtë e hilafetit janë zgjeruar, dikush ka mundësi të ikë dhe të struket një kohë të shkurtë a të gjatë. Por, s'është çare pa u zbuluar çerdhja e tij. Së shpejti do t'i biem fijesh dhe do ta kapim.

HAXH-XHAXHI

Mbani që të dy në burg derisa ta kapim edhe të tretin. Nuk do të ikë Ibni Xhubejri nga grushti im, se unë jam Haxh-xhaxhi, i biri Jusufit!!

(PERDJA)

PJESA E DYTË (AKTI I PARË)

Seid bin Xhubejri i fshehur në shtëpinë e njërit nga talebet e tij në Mekke. Talebet janë ulur në formën e gjysëmrrrethit rreth hoxhës së tyre.

SEIDI

Me emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit. I bëjmë hamd All-llahut e i çojmë salavat dhe selam Pejgamberit, familjes, shokëve dhe të gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij.

Na është përcjellë nga Muadh bin Xhebeli se Pejgamberi alejhisselam ka thënë: “Biri i Ademit nuk mund të hapërojë Ditën e Kijametit para se t’ju përgjigjet katër pyetjeve: Jetën e vet ku e harxhoi; rininë e vet ku e çoi; pasurinë e vet si e fitoi dhe kujt ia ndau; diturinë e vet sa e praktikoi”.

Bijtë e mi, ky hadith është barrë e rëndë për bartësit e diturisë, se nesër All-llahu pa dyshim do t’i pyesë sa e praktikuan diturinë e vet dhe ç’vepruan me të. Ashtu do të pyetet edhe çdo i moshërritur për dhuntitë e All-llahut që ia dhuroi, ç’veproi me to. Dhuntitë e jetës, të rinisë, të pasurisë dhe në fund të diturisë. Me diturinë All-llahu e dalloi nga shtazët. Dituria, o bijtë e mi, është dhunti shumë e çmueshme. All-llahu ia falë prej robërve të Tij vetëm atij që do. Ndërsa falënderimi ndaj këtij ni’meti është të veprosh sipas saj dhe t’ua mësosh të tjerëve. Kush merr dituri dhe vepron sipas saj, vetëm ai ka marrë dituri dhe meriton të quhet dijetar dhe edukator. E kush mëson diçka e pastaj e fsheh nga njerëzit, kurse ata kanë nevojë për diturinë e tij, do të

gjuhët Ditën e Kijametit me gaca të zjarrit. Ndërsa ai që mëson dhe nuk vepron sipas asaj që e ka përvetësuar, i përngjanë gomarit të ngarkuar me libra të çmuar. Gjëja që më së shumti e frikësonte Muhammedin alejhisselam për Ummetin pas vdekjes së tij ishte munafiku i dijsëm.

NJËRI PREJ TYRE

(I habitur) Munafiku i dijsëm! Si është e mundur që njeriu të jetë njëkohësisht dijetar dhe munafik?!

SEIDI

Dijetari që gjuhën e ka të mprehtë kurse zemrën të zbrazët nga droja ndaj All-llahut. Nga Aliu radijall-llahu ahnu përcillet se Pejgamberi alejhisselam ka thënë: “Vërtet, unë nuk brengosem për ju nga ndonjë besimtar apo mushrik. Besimtarin e mbron imani i tij, kurse mushrikun e asgjëson kufri i tij. Por brengosem për ju nga ndonjë munafik që diturinë e ka vetëm në gjuhë. Flet për atë që ju e doni, kurse punon për atë që ju e urreni”.

Bijtë e mi, ky pra është ai që kokën e ka përplot dituri, kurse zemrën e ka të zbrazët nga droja ndaj All-llahut.

NJË TJETËR

E cila është shenja e drojës ndaj All-llahut?

SEIDI

Shenja e drojës ndaj All-llahut është të vesh kufi mes vetes dhe gjynaheve.

NJË TJETËR

Çka e ndihmon njeriun t'ia ketë drojën All-llahut?

SEIDI

Përkujtimi i vdekjes dhe ahiretit. Kjo i pastron zemrat e damkosura dhe ia zvogëlon njeriut lakminë ndaj kësaj bote. Pejgamberi alejhisselam na ka lënë dy këshilltarë. Njëri flet e tjetri hesht. Ai që flet është Kur'ani ndërsa ai që hesht është vdekja. Këta dy këshilltarë mjaftojnë për besimtarin. Zemra e besimtarit fillon të varfërohet pikërisht kur e kaplon harresa e vdekjes.

NJË OTJETËR

A nuk kuptohet nga kjo se besimtari e nënçmon jetën dhe e urren atë?

SEIDI

Jo o biri im, çdo ditë për besimtarin është me vlerë. Gjatë jetës ai e adhuron All-llahun, është i dobishëm për krijesat e Tij dhe i kontrollon veprimet e veta. Kjo jetë për njeriun është arë e ahiretit. Sot mbjell në këtë botë, nesër korr në tjetrën. *(Pastaj ju drejtobet me këshillë të gjithëve)* O bijtë e mi, kjo botë në peshojën e All-llahut nuk peshon as sa krahu i mushkonjës. Vetëm në dynja i bëhet gjynah All-llahu, vetëm në të kundërshtohen urdhrat e Tij, prandaj edhe është e mjerë. Armiqtë e All-llahut në këtë botë argëtohen dhe sillen me arrogancë, ndërsa dashamirët e Tij shtypen dhe torturohen. Të mjerët ju nëse ju tërheq kjo botë dhe e harroni tjetrën. All-llahu dynjanë ia jep atij që e do, por edhe atij që nuk e do, kurse fenë dhe ahiretin ia jep vetëm atij që e

do. Dine se nuk ka vlerë feja pa dituri, por edhe nuk ka vlerë dituria pa vepër. Po ashtu edhe vepra nuk ka vlerë pa sinqeritet në të. Unë lus All-llahun e Madhërishëm t'ju bëjë thesar timin pas meje dhe t'ju ndihmojë me kujdesin dhe suksesin e Tij, ashtu që të jeni prej atyre që mësojnë për të vepruar, që veprojnë për ta treguar sinqeritetin dhe janë të sinqertë për ta fituar kënaqësinë e All-llahut dhe xhennetin.

NJË TJETËR

Kjo porosi sikur është lamtumirëse o Ebu Abdull-llah?!

SEIDI

Po vall-llahi kush e di, ndoshta ky është takimi i fundit me ju në këtë botë kalimtare.

NJË TALEBE

All-llahu e lashtë hoxhën tonë që të përfitojmë prej tij edhe më shumë.

SEIDI

Ju sigurisht keni dëgjuar se ai zullumçar i ka lëshuar vëzhguesit dhe ushtrinë e vet që të më kërkojnë anekënd vendit. Po më duket se ata do t'më zënë dhe kuptohet, do t'më mbysin.

TALEBET

(Me dhimbje dhe pikëllim) Me mish e me shpirt kurban do të bëhemi për ty dhe do të mbrojmë me të gjitha forcat.

SEIDI

Vdekja është fundi i çdo të gjalli. Ai që nuk vdes nga shpata, vdes nga diç tjetër.

Shija e vdekjes prej ndonjë shkaku të urrejtur,
është si shija e vdekjes prej shkakut të dashur.

Unë nuk përsëris përpos asaj që e thanë të devotshmit: “Zot na shto durimin dhe na vdes muslimanë”. Dëgjoni, një ditë ishim ulur unë dhe dy shokë të tjerë. I bëmë lutje All-llahut çdonjëri në vete, kështu që ndjenim shpirtërisht ngrohtësinë dhe ëmbëlsinë e duasë. Në fund, bashkërisht lutëm All-llahun të na bëjë shehid të Islamit. Dy shokëve të mi All-llahu ua plotësoi dëshirën dhe fituan atë që e kërkuan. Kurse unë, ja po e pres atë rast me lejen e All-llahut.

NJË TJETËR

Si të heshtim ndaj këtij diktatori zullumqar?

SEIDI

O biri im, All-llahu i Madhërishtëm ka planin e vet dhe pa dyshim ai do të realizohet. Ne, dijetarët, ngritëm zërin tonë kundër këtij njeriu dhe iu bashkangjitëm kryengritjes së Ibnul Esh’athit. I lamë

librat dhe i formuam aradhat, i lamë lapsat dhe i kapëm shpatat. Kështu ne shtimin e dijetarëve e zëvendësuam me gjakun e dëshmorëve. Ne deshëm të arrijmë diçka, por All-llahu dëshiroi diç tjetër. Na sprovoi imanin dhe durimin tonë. Dikush prej nesh vdiq, dikush u robërua, e dikush iku.

NJË TALEBE

A kanë të drejtit ndonjë gjynah nëse e humbin luftën prej zullumqarëve?

SEIDI

Nuk kanë gjynah me emër të All-llahut. Sikur të pajtoheshim me padrejtësinë dhe t'i ndihmonim zullumit, atëherë gjynahu ynë do të ishte i madh. Por, nëse përpiqemi dhe angazhohemi, kjo është mundësia jonë, kurse rezultatet dhe sukseset nuk i bartim ne por janë në duart e All-llahut. All-llahu nuk do të na pyesë pse nuk korrët sukses, por pse nuk i luftuat padrejtësitë.

(Një talebe me emrin Umejr)

UMEJRI

Këtij terri a nuk do t'i vijë fundi? Deri kur e drejta do të trajtohet si gjynah? Deri kur do të mbyten thirrësit e hakut, deri kur do të torturohen dijetarët dhe përkrahësit e tyre? Padrejtësitë po shtohen dhe përhapen në bazë të numrit dhe forcës së tyre ushtarake. Tallen me gjakun, pasurinë dhe nderin tonë ashtu siç dëshirojnë. Nuk ka kontroll as rezistencë të mirëfilltë. A nuk jemi ne të drejtë e këta zullumqarë në padrejtësi?!

SEIDI

Ç'thua kështu o Umejr?! A dyshon në përpjekjet tona?! Pasha All-llahun nëse na bëjnë edhe grima-grima e na rrëmbejnë shpendët dhe na hanë egërsirat, nuk dyshojmë në drejtësinë tonë dhe në padrejtësinë e këtyre zullumqarëve.

UMEJRI

Ç'po ndodh, ata vetëm po fitojnë e ne po humbim?

SEIDI

I mjeri ti! Ne humbim vetëm atë ditë kur dyshojmë se jemi misionarë të hakut ose u dorëzohemi atyre që janë zullumqarë. Pa dyshim i drejti, edhe nëse është i vetëm dhe qëndron këmbëngulës në drejtësinë e tij kundër zullumit të armatosur, ai veç ka fituar. Ka fituar edhe pse shkurtpamësit e shohin të nënshtruar dhe të humbur. A doni t'u tregoj një shembull? Shembulli më i mirë në historinë tonë është Resulull-llahu në Ditën e Hixhretit. Ditën kur doli nga shtëpia dhe vendlindja e tij, i shtypur, i dëbuar, pastaj edhe i fshehur në shpellën Mu'tem. Si e konsideroni këtë qëndrim? A ishte humbëtar apo fitues?

(Talebët beshtin pa përgjigje)

SEIDI

Pse nuk përgjigjeni?!

NJËRI PREJ TYRE

Cili besimtar guxon ta përshkruajë si humbës Pejgamberin alejhisselam, kur atë All-llahu e përkrahu me ndihmën e Tij.

SEIDI

Ia qëlllove. Mirë, a ishte këtë ditë fitimtar?

(Talebja habitet dhe nuk jep përgjigje)

SEIDI

Unë këtë ditë e konsideroj vetëm si ditë fitore dhe krenarie për Islamin. E pse jo, kur All-llahu në librin e Tij e përshkruan këtë ngjarje... dëgjoni këtë deklaratë hyjnore: “Në mos e ndihmofshit atë (Pajgamberin), atë e ka ndihmuar All-llahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin, kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: Mos u pikëllo, All-llahu është me ne!”. Pra, All-llahu i ndihmoi këtë ditë, ditën e shpellës. Prandaj edhe s’guxon askush ta quajë Pejgamberin alejhisselam humbës kur All-llahu e ndihmoi. Dhe ja, Umeri i drejtë dhe i frymëzuar, vërejt i këtë vlerë të madhe të Ditës së Hixhretit, prandaj edhe me të drejtë e bëri çelës të historisë islame. A mund të jetë e logjikshme që historia e muslimanëve të fillojë me një ditë që Islami humbi në të?!!!

UMEJRI

Kërkoj falje o hoxha im. Ndoshta të hidhërova me fjalët e mia. Unë thash çka thash, sepse njeriu është krijuar i ngutshëm. Kur po shoh sprovat, torturat dhe pasojat e muslimanëve të sinqertë, po më ngushtohet gjoksi dhe po më humb durimi. Posaçërisht kur i shoh shkaktarët e shkatërrimit, vetëm bëjnë trazira në tokë dhe asgjë nuk përmirësojnë, kurse vetë jetojnë në bollëk dhe rehati. Toka ka marrë stolinë dhe është zbukuruar për ta, saqë mendojnë se janë të zotët e saj!

SEIDI

Ngadal o biri im, se sprovat dhe mundimet janë domosdoshmëri e bartësve të shpalljeve dhe trashëgimtarëve të Pejgamberëve. All-llahu në këtë mënyrë i sprovon qëllimet dhe i shoshit zemrat e tyre, që t'i dallojë qëllimkëqijtë nga qëllimmirët. Kënaqësitë që i përjetojnë shkatërrimtarët nuk janë asgjë përveç kurth i All-llahut që Ditën e Gjykimit t'ua shtrojë argumentet dhe t'ua mbyllë gojën nga arsyetimet. Kështu Fuqiploti i kap me grushtin e Tij siç përshekruhet në Kur'an: "Meqë lanë pasdore atë me çka u këshilluan (t'i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) derisa u gëzuan për atë që ju kishte dhënë, i kapëm befas, e ata mbetën të zhgënjyer. Ndaj u zhduk mbeturina e fundit e popullit mizor, pra falënderim i qoftë Zotit të botëve". O bijtë e mi, i tillë është Ligji i All-llahut në këtë botë. Ditët i qarkullon në mesin e njerëzve. Një ditë në favor tëndin e një ditë në favor të tjetërkujt. Por kjo qarkore pa dyshim ka fundin e mirë, ndërsa ai u takon besimtarëve që ia kanë drojën vetëm All-llahut.

A thua o Umejr u qetësua zemra yte, apo ende në gjoksin tënd ndjen ngushtësi? Nëse kjo ende të mundon o biri im, atëherë ke nevojë ta lexosh Kur'anin rishtazi, duke u përqëndruar me zemër të

zgjuar. Atëherë me siguri do të kuptosh se si All-llahu i sprovon robërit e vet që t'ua forcojë imanin e t'i mposhtë mosbesimtarët. A të kujtohet fillimi i sures "Ankebut" kur All-llahu i Madhërishëm thotë: “Elif, Lam, Mimë. A menduan njerëzit të thonë: 'Ne kemi besuar', e të mos vihen në sprovë?”, pastaj fjala e Tij në suretull "Furkan": “Ne bëmë njërin prej jush sprovë për tjetrin se a do të jeni të durueshëm”, por edhe fjala e Tij në suren "Muhammed": “Kështu pra, po sikur të dojë All-llahu, Ai do të hakmerrej ndaj tyre, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë njërin me tjetrin. E ata që ranë dëshmorë në rrugën e All-llahut, atyre kurrsesi nuk ua humb veprat (por ua shton)”, dhe po në të njëjtën sure: “Ne do t'ju sprovojmë juve, por edhe do t'i sprovojmë veprat tuaja”. Vall-llahi shokët e mi po i përjetojnë sprovat më të rënda e unë po qëndroj në vend të sigurt. Tani kam filluar ta urrej edhe veten time dhe po mendoj se nga izolimi im askush nuk do të ketë dobi. Kam shpresë se së shpejti do të takohem me shokët e mi dhe do ta arrij fatin e thirrësve në rrugë të All-llahut.

UMEJRI

All-llahu të shpërbleftë me të mirat e imamëve të drejtë. Tani vall-llahi edhe unë dua të sprovohem.

SEIDI

Besimtari i lutet All-llahut për rehati e jo për telashe. Por kur ato e qëllojnë, qëndron i durueshëm ashtu siç ishin të durueshëm heronjtë e Islamit.

(Befas hyn njëri prej policëve dhe i pyet)

POLICI

Mos lëvizni. Kuptova se në mesin tuaj qëndron Seid bin Xhubejri. Cili prej juve është ai?

TALEBET

(Njëzëri) Unë.

POLICI

Çudi, a të gjithë jeni Seid bin Xhubejri?!

TALEBET

Po, të gjithë jemi Seid bin Xhubejri.

POLICI

Seid bin Xhubejri, një është apo dhjetë?! Prej juve njëri është Seidi. Më tregoni e mos ma ngatërroni mendjen, përndryshe e lajmëroj emirin, pastaj ju zë dënimi të gjithëve.

NJËRI PREJ TYRE

Unë jam Seid bin Xhubejri.

TJETRI

Mos i beso, unë jam Seidi.

I TRETË

Mos i beso asnjërit, se pasha All-llahun unë jam Seidi.

POLICI

Po betohesh në All-llahun se ti je Seidi?!

SEIDI

Mos ju beso, o biri im. Unë jam Seidi e këta janë talebet e mi. A kujton se Seid bin Xhubejri është i ri. Seidi po i kalon të 57-tat e këta të gjithë janë të njomë si po i sheh. Si mund të besosh se ndonjëri prej tyre është Seid bin Xhubejri.

POLICI

Vërtet, si u habita. *(I kthehet atij i cili u betua se është Seidi)* Si ore u betove se je Seidi? Talebe i Islamit dhe betohesh rrejshëm?!

TALEBJA

Nuk u betova rrejshëm dhe nuk e tejkalova realitetin aspak. Thash: Pasha All-llahun unë jam Seidi, që don të thotë “i gëzuari” dhe kjo është e vërtetë. Pasha atë që ka shpirtin tim në duart e Tij, unë jam i gëzuari dhe më i lumturi nëse bëhem kurban për dijetarin islam Seid bin Xhubejrin.

POLICI

S’kam parë si sot kaq të lartësohet njeriu dhe t’i bëhen kurban të tjerët. E vraftë All-llahu Haxh-xhaxhin!! Na shfrytëzon për shqetësimin dhe keqtrajtimin e muslimanëve, e veçanërisht dijetarëve të fesë. Mallkuar qoftë kjo detyrë. (*Pastaj i kethebet Seidit*) O hoxhë, pasha All-llahun do të lë të lirë. Lutem që All-llahun ta takoj me duar të pastra dhe këto duar të jenë larg dorëzimit tënd zullumqarëve diktatorë. E ju bijtë e hoxhës, ju lus sinqerisht të mos lajmëroni askënd se jemi takuar. Mos harroni se nëse e kupton diktatori se kam qenë te ju, dënim tjetër përpos shpatës nuk më pret (*bën me shenjë në qafë*). Vall-llahi sikur mos të ishin çunat e vegjël që duhet ushqyer, nuk do të mbetesha në këtë vend të punës kurrë. O Zot, më mbulo me mëshirën Tënde dhe faljen Tënde. (*Polici i bën dy bapa e pastaj kethebet dhe ju thotë*) Do të ishte më mirë që hoxha ta lëshojë këtë shtëpi e të vendoset larg rrapëllimave të vëzhguesve. Ndoshta All-llahu Fuqiplotë ua verbon sytë zullumqarëve.

NJËRI PREJ TALEBEVE

Falënderim All-llahut, hajri nuk shteret në ummetin islam deri në Ditën e Kijametit. Kush do të besonte se ka polic me zemër të tillë.

(Del polici ndërsa Seidi drejtohet kah talebet e tij)

SEIDI

Më turpëruat o bijtë e mi me këtë qëndrim. Unë, pasha All-llahun, nuk kam mundësi t'ua kthej. Këtë po ia lë All-llahut. Ai le t'ju shpërblejë me të mirat e Tij, se të gjitha pasuritë janë në duart e Tij.

O bijtë e mi, ata të cilët bashkohen në interes të dynjasë sot, pa dyshim do të ndahen nesër. Lidhja të cilës nyja kurrë nuk i ndahet është lidhja në emër të All-llahut. Andaj edhe kini kujdes që gjithmonë të mbetet ndërmjet jush bashkimi për All-llahun dhe në emër të Tij. Çdo lidhje që i përket All-llahut është më e fortë se çdo lidhje farefisnore. A nuk ju kujtohet fjala e Të Gjithëdijshmit në Kur'an: "Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi".

Qofshi nën kujdesin e All-llahut përherë o bijtë e mi!

(PERDJA)

(AKTI I DYTË)

Seidi në një shtëpi larg Mekkes diku në skaj të qytetit. Brenda hyn Ebu Husajni, shok i Seidit.

EBU HUSAJNI

A e di o Ebu Abdull-llah se çka u tha njerëzve në xhami valiu i ri i Mekkes?

SEIDI

Jo, nuk e di. Ç'ju ka thënë?

EBU HUSAJNI

Pasha Atë që bëjmë haxhillëkun për Të, nëse e gjej Seidin do t'ia rrënoj kasollen me gjithë të. Para vete keni vetëm tri ditë. Kështu i shashtisur dhe i çoroditur bërtiste. Jam i informuar se dikush i ka treguar për vendstrehimin tënd. Me siguri do t'i dërgojë njerëzit e vet, andaj më dëgjo e largohu sa më shpejtë dhe strehohu gjetiu.

SEIDI

O Ebu Husajn, aq kam ikur dhe jam fshehur saqë po turpërohem para All-llahut. Më le të lirë këtu derisa All-llahu të gjykojë me një çështje që është vendosur.

EBU HUSAJNI

Pasha All-llahun, po të shoh të gëzuar mu ashtu siç të ka emëruar nëna yte. Qofsh nën kujdesin e All-llahut!

SEIDI

Qofsh edhe ti nën kujdesin e All-llahut, i cili kurrë nuk mungon.

(Del Ebu Husajni. Pas pak kobe dikush troket në derë. Hyn një njeri që e kishte dërguar valiu për ta zënë)

NJERIU

Valiu është njoftuar për vendstrehimin tuaj. Më dërgoi të të marr dhe të të dorëzoj. Lus All-llahun të më ruajë nga kjo punë e fëlliqtë. Ik në ndonjë vend tjetër e mos u brengos se nuk të lë vetëm.

SEIDI

Kam ikur e jam fshehur aq shumë sa që po turpërohem prej All-llahut. Do të bëhet ashtu siç ka vendosur All-llahu.

NJERIU

Ne ikim prej kaderit të All-llahut në kaderin e All-llahut. Beso se nuk kam frikë për ty sa kam frikë për këtë ummet, që mos vallë do ta përfshijë përbuzja e All-llahut me mbytjen e dijetarëve. Më dëgjo e të ikim, ashtu siç iku Musa prej Faraonit: “Tha: O Zoti im, më shpëto prej popullit zullumqar”.

SEIDI

(Fjalët e njeriut shpirtërisht ndikojnë tek Seidi) A ke familje këtu?

NJERIU

Familjen e lash në duart e All-llahut.

SEIDI

Jo për Zotin, kurrë nuk bëhem shkaktar për torturimin e një besimtari.

Zbatoje atë për të cilën je i urdhëruar, All-llahu do të shpërblejë për qëllimin e mirë që ke.

NJERIU

Valiu do të të dorëzojë te Haxh-xhaxhi. E ti e di kryeneçësinë dhe ashpërsinë e tij.

SEIDI

Le të jetë ky vullneti i All-llahut. Ti s'ke faj, zbatoje atë që të është urdhëruar.

NJERIU

Unë e pranova prej valiut këtë detyrë vetëm që të të shpëtoj e të ikim në ndonjë vend të sigurt. Si tani më detyron të t'i lidhë duart me pranga dhe të të dorëzoj te njeriu që nuk mëshiron askënd?! Të lutem më dëgjo kësaj here e të ikim sa më shpejtë.

SEIDI

Të torturohet familja dhe fëmijët tu për shkak timin? Këtë nuk e pranoj kurrë. Ja, merrmi duart e m'i lidh ato.

NJERIU

(Nga sytë fillojnë t'i pikojnë lotët, afrohet dhe duke ia lidhur duart thotë zëshëm) S'ka vullnet që mund ta pengojë kaderin e All-llahut. O Zot, Ti e di se këtë vepër me urrejtje po e bëj. Ne jemi të All-llahut dhe tek Ai kthehemi.

(PERDJA)

PJESA E TRETË (AKTI I PARË)

Odë burgu. Brenda qëndrojnë tre fukahatë e famshëm, Amir Esh-sha'bi, Matraf bin Abdull-llahu dhe Seid bin Xhubejri.

ESH-SHA'BI

Çka ka të re në këtë mëngjes te ti o Matraf?

MATRAFI

Pashë një ëndërr. Shpresoj se kam myzhde të mirë prej saj. Po e komentoj se do të dal nga ky burg i mërztitshëm.

SEIDI

(I hamendur) Nuk është hajri vetëm në daljen nga burgu. Hajri do të jetë gjithmonë kur të jemi këmbëngulës ndaj hakut. Jusufi i drejtë, midis veprës së pandershme dhe burgut zgjodhi burgun. Ai tha: “O Zoti im, burgu është më i dashur për mua se sa ajo që më ofrojnë ata mua”.

ESH-SHA’BI

Por ky nuk është vetëm burg o Ebu Abdull-llah, është vrasje, është prerje!

SEIDI

“E sikur të ishit mbytur në rrugë të All-llahut ose t’u kishte zënë vdekja, do të gëzonit falje e mëshirë prej All-llahut, që është më e dobishme se ajo çka ata grumbullojnë”.

MATRAFI

A do t’ua dorëzosh qafën këtyre zullumqarëve që nuk e kanë frikë Krijuesin dhe nuk i mëshirojnë krijesat?

SEIDI

(Vë dorën në qafë) Çka do të humbë Ibni Xhubejri nëse i ndahet kjo nga kjo *(qafa nga koka)* në rrugë të All-llahut. *(Me dëshpërim dhe keqardhje u drejtohet:)* O njerëz, a harruat se ç'kërkojnë këta prej jush? Kërkojnë që të pranoni para tyre se jeni kundër xhematit, jeni murtedë dhe keni bërë kufër kur jeni ngritur kundër tyre! A pranoni se jeni kafirë?

ESH-SHA'BI

“Përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre”.

SEIDI

E ti o Matraf, ke vendosur para zullumqarit të pranosh se je kafir?

MATRAFI

O Ebu Abdull-llah, në mospajtime ka mundësi të përdoren edhe mashtrimet. Do të përdorë fjalë të koklavitura me qëllim të hiles që të ikë nga përgjigjja e saktë dhe e qartë.

Po ti o Seid, pse nuk vepron siç do të veprojmë ne e ta shpëtosh kokën?

SEIDI

E çfarë vlere ka koka e Seidit në krahasim me kokat e Pejgamberëve, dëshmorëve dhe muslimanëve të sinqertë. A nuk u nda në dy pjesë Zekerijjau alejhisselam me sharrë, a nuk u pre

zotëriu i ruajtur Jahja alejhisselam? A nuk e dëgjuat nga Pejgamberi alejhisselam fjalën e tij: “Xhiahadi më i mirë është fjala e drejtë para sulltanit zullumqar”? A nuk u mbytën padrejtësisht dhe pa faj Umeri, Uthmani, Aliu dhe Husejni radijall-llahu ahnum?!!

ESH-SHA’BI

Gjithsesi... por edhe unë e thash fjalën e hakut, madje edhe luftova për hir të saj, pastaj deshti All-llahu dhe ja se ç’ndodhi. Patjetër na duhet durimi derisa të na piqen kushtet për ndonjëherë tjetër.

SEIDI

Do të mbetem me fjalën e hakut, do të jetoj me të, do të vdes për të dhe me të do t’i luftoj diktatorët zullumqarë, e All-llahu do të jetë fitimtar për çështjen e Tij.

MATRAFI

Zine se e thash fjalën e hakut qartë. Por a do të hiqet zullumi i diktatorëve apo diktatura e zullumqarëve e të zgjidhet kjo nyje e rëndë?

ESH-SHA’BI

Kurrsesi, do të mbytet Seid bin Xhubejri, dijetar dhe fakih, e do të mbetet Haxh-xhaxhi, diktator dhe zullumqar. Mbetet pushteti i zullumit dhe dhunës ashtu siç është.

SEIDI

(I pezmatuar) Ç'është kjo që e dëgjoj prej juve dyve! Edhe ju i flitni këto fjalë? Kur ka qenë lakmia e kësaj jete qëllim i Pejgamberëve dhe trashëgimtarëve të tyre? Pasha All-llahun, çdo shehid që bie dëshmor për ngritjen e fjalës së All-llahut, dridhë tokën nën këmbët e zullumqarëve. Zullumi ndoshta mbetet një kohë të caktuar, por mbetet i izoluar, në lidhje të pasigurta, pa qetësi, rehati e stabilitet. Pemën e Islamit nuk e ushqen dhe zhvillon asgjë tjetër, përpos gjaku i dëshmorëve. Ata japin shpresë se ummeti ende është në hajr dhe se në të ka kush që shet shpirtin për All-llahun me iman dhe vullnet.

(Esh-sha'bi dhe Matrafi preken thellë nga fjalët e Seidit).

ESH-SHA'BI

Na fal o Ebu Abdull-llah. Ne patëm për qëllim të të mbrojmë ty se ummeti ka nevojë për ty. Njerëzit janë të nevojshëm për ty o Seid, të nevojshëm për dijen dhe fikhun tënd.

SEIDI

O Sha'bi, aq sa janë njerëzit të nevojshëm që dikush t'ua mësojë fikhun, aq janë të nevojshëm që dikush edhe t'i mësojë si të qëndrojnë këmbëngulës në hakun kundër diktatorëve zullumqarë.

MATRAFI

O Seid, ne veten jemi duke e parë në një shkallë më të ulët. Ta lëmë o Sha'bi, se në fytyrën e tij është kah shkëlqen gjaku i shehidit.

SEIDI

“Thuaj: ‘Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni’. Prandaj vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët”.

(Roja e burgut hap derën. Brenda hyjnë tre persona. Ata u afrohen hoxhallarëve. Njëri prej tyre i drejtohet Matraf bin Abdull-llahut)

NJERIU

A më jep fetfa o hoxhë, All-llahu të mëshiroftë?

MATRAFI

Këta dy janë imamët e Kufes dhe fakihët e saj. Këta të japin fetfa.

NJERIU

E kush janë këta dy, All-llahu sjelltë dobi me ty?

MATRAFI

Ky është Seid bin Xhubejri e ky Amir Esh-sha’bi.

SEIDI

E ky është Matraf bin Abdull-llahu.

NJERIU

S'ka ndryshim e as forcë përpos me All-llahun! Dijetarët burgosen dhe torturohen, kurse fasikët zullumqarë jetojnë të lirë dhe argëtohen.

(Njeriu i drejtobët Seidit dhe i thotë)

NJERIU

Më jep fetfa o imam. I jam betuar gruas sime se Haxh-xhaxhi është xhehennemli, nëse jo, atëherë qofsh e lëshuar. A duhet të lëshohet gruaja ime?

SEIDI

Pyete Sha'biun, të përgjigjet.

NJERIU

(I drejtobët Sha'biut:) Ç'do të thuash për këtë rast?

ESH-SHA'BIU

O njeri, nëse Haxh-xhaxhi është në xhennet pas gjithë asaj që ka bërë, atëherë edhe ty nuk të dëmton aspak të mbetesh me gruan tënde në haram.

NJERIU

Vall-llahi, ma shërove zemrën.

(Afrohet tjetri dhe e pyet)

I DYTË

O imam, më jep fetfa, Haxh-xhaxhi a është mu'min apo kafir?

ESH-SHA'BIU

(Me ironi) Haxh-xhaxhi është mu'min.

I TRETË

Haxh-xhaxhi, diktatori, zullumqari dhe i pashpirti, vrasësi i muslimanëve dhe armiku i tyre, shtypësi i të lirëve dhe faraoni i arabëve na qenka mu'min?!!

ESH-SHA'BIU

Po, po, mu'min i zullumit dhe diktaturës, kurse kafir ndaj ajeteve të Kur'anit.

I TRETË

Kështu po, mund ta pranoj.

(Hyn roja e burgut. Të pranishmit i gjenë të beshtur)

ROJTARI

Pse heshtët kur hyra brenda?

SEIDI

All-llahu e mëshiroftë njeriun i cili kur flet fiton, e kur hesht shpëton.

ROJTARI

O hoxhë, po dukesh se je prej takvalive. Ç'do të thuash për ndihmëtarët e zullumqarëve?

SEIDI

Ndihmëtarët e zullumqarëve janë qentë e xhennemit, aty lehin siç lehin qentë.

ROJTARI

Ç'thua për mua, a jam prej ndihmëtarëve të zullumqarëve?

SEIDI

Jo, ndihmëtarë të zullumqarëve janë ata që t'i lajnë teshat, të përgatisin ushqimin e kështu me radhë.

ROJTARI

(Me habi) Po unë?

SEIDI

Ti! Ti je prej vetë zullumqarëve. A nuk je i angazhuar për nëpërkëmbjen e krijesave të All-llahut? All-llahu i Madhëruar kur i mallkoi Faraonin dhe Hamanin, me ta mallkoi edhe ushtrinë e tyre. Në Kur'an thuhet: “Andaj, Ne e kapëm atë dhe ushtrinë e tij dhe i hodhëm në det, e shiko pra se si përfundojnë mizorët”.

ROJTARI

Por unë nuk guxoj të them për asgjë “Jo”.

SEIDI

Sikur të mos e shihnin ashpërsinë e shpirtit tënd, nuk do ta jepnin këtë detyrë.

ROJTARI

Për këtë punë marr rrogë. Sikur të mos ishte kjo, fëmijët e mi do të mbetnin të uritur.

SEIDI

Rizku i All-llahut është çdokund. Nëse do, mund të gjesh punë tjetër.

Mos iu bën shok zullumqarit. Kush është i sinqertë ndaj All-llahut, All-llahu është i sinqertë ndaj tij. “E kush i druan All-llahut, Ai atij i sjell rrugëdalje dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij”.

ROJTARI

(I ngre duart drejt qiellit dhe thotë:) O Zot, Ti e di se unë punoj si rojtar te këta sundimtarë që zemra ime i mallkon. O Zot, unë kërkoj strehim te Ti nga një punë që të jem zullumqar ose t'i ndihmoj zullumqarit. O Zot, më fal mua për të kaluarën time dhe më gjej rrugëdalje në ardhmërinë time.

(PERDJA)

(AKTI I DYTË)

Haxh-xhaxhi në Kuvendin e Vilajetit, i mbështetur në kolltukun e tij. Nga e majta i qëndrojnë disa nga rojat. Hyn shefi i policisë.

HAXH-XHAXHI

Sillni tre të akuzuarit një nga një.

(Hyjnë që të tre. I afrohet Matraf bin Abdull-llabut)

HAXH-XHAXHI

A e di se çka ka shkruar halifja për ju?

MATRAFI

E di.

HAXH-XHAXHI

A je kafir apo besimtar?

MATRAFI

All-llahu e pastë në kujdesin e Tij emirin. Ai i cili e theu grushtin, kundërshtoi besëlidhjen, tradhtoi paqen, iu largua Sunnetit dhe i frikoi muslimanët e meriton kufrin.

HAXH-XHAXHI

(Atyre që janë pranë u drejtohet me krenari) Pranoi kufrin që e bëri dhe shpëtoi. Le të lirohet.

ROJA

(Pëshpërisin) Pasha All-llahun, ky hoxhë sikur deshti ta kundërshtojë emirin!
(Hyn Sha'biu, ndërsa portieri i flet në vesh)

PORTIERI

Prano se je kafir, do ta shpëtosh kokën tënde.

(Haxh-xhaxhi me kokën ulur nuk vëren asgjë. Kur e ngre kokën e sheh dhe i thotë:)

HAXH-XHAXHI

E ti o Sha'bi, ti je ai që na kundërshtove dhe iu bashkangjite trazirave?

ESH-SHA'BI

All-llahu e pastë në kujdesin e Tij emirin. Njerëzit më këshilluan që të pranoj diçka që ti të jeshë i kënaqur, e ta përbuzë All-llahun. Unë ashtu s'guxoj të veproj, por fjalëve tua u besoj. Ti o emir na e tërhoqe vëmendjen se kjo është fitne e verbër, kurse ne nuk ishim as të mirë e të devotshëm e as të këqij e të fuqishëm, derisa ndodhi ajo që ndodhi.

HAXH-XHAXHI

(Rojes së tij:) Foli drejt. Pasha All-llahun, as nuk ishin të mirë me devotshmëri që të qëndrojnë neutralë e të mos na luftojnë, e as të këqij e të fuqishëm e të na mundin. Ta falim gabimin. Sillne hoxhën e telasheve dhe kryet e fitneve.

(Hyn Seid bin Xhubejri)

HAXH-XHAXHI

(Shtiret që nuk e njeh) Kush je ti?

SEIDI

Seid bin Xhubejri.

HAXH-XHAXHI

Jo, por i humburi, i biri i ngatërresave.

SEIDI

Nëna ime e di më mirë emrin tim dhe të babait.

HAXH-XHAXHI

I humbur je dhe e ke humbur nënën tënde.

SEIDI

I humbur është ai që është prej xhehennemlive. A mos ke arritur ta zbulosh edhe të fshehtën, ardhmërinë?

HAXH-XHAXHI

Pse ike dhe u fshehe tërë këtë kohë?

SEIDI

Them atë që e ka thënë Musa alejhisselam: “Tka prej jush kur u frikësova nga ju”.

HAXH-XHAXHI

(Me ashpërsi) A më kundërshton?

SEIDI

(I qetë) Jo, por po e tregoj realitetin.

HAXH-XHAXHI

Besimtar je ti apo kafir?

SEIDI

(Fuqishëm) Nuk i kam bërë kufër All-llaut që kur i besoj.

HAXH-XHAXHI

A supozon se je besimtar o munafik! Vall-llahi do të të hedh në gropë të vdekjes.

SEIDI

(I qartë dhe i bindshëm) Atëherë pra nëna ime ia paska qëlluar kur më paska quajtur Seid (i gëzuar). A ka gëzim më i madh se të bëhesh dëshmor në rrugë të All-llahut dhe të jeshë në fqinjësi të babait të shëhidëve, Hamzës r.a.

HAXH-XHAXHI

(Me nënçmim dhe kërcënim) Nuk do të shoqërosh askënd përveç rebelëve dhe murtedëve. Do ta zëvendësoj këtë botë me zjarr të këndellur.

SEIDI

(I sigurt) Sikur ta dija se kjo është në duart tua, do të të kisha besuar ty për Zot e jo All-llahun.

HAXH-XHAXHI

(I hidhëruar) I mjeri ti, o i humbur!

SEIDI

Mjerim është për atë që se shijon xhennetin dhe hyn në zjarr.

(Haxh-xhaxhi e drejton bisedën në kabe tjetër)

HAXH-XHAXHI

Çka mendon për halifët. Cili është më i mirë?

SEIDI

(Ia mbyll këtë derë të polemikës) Nuk jam përgjegjës për ta, e as që kam qenë mbikëqyrës i tyre.

HAXH-XHAXHI

Cili është më i dashur për ty?

SEIDI

Ai që është më i dashur te Krijuesi i tij.

HAXH-XHAXHI

E cili është më i dashur te Krijuesi i tij?

SEIDI

Këtë e di Ai që i di fshehtësitë dhe pëshpëritjet e tyre.

HAXH-XHAXHI

Refuzon ta tregosh të vërtetën.

SEIDI

Jo, por nuk desha të të gënjej.

HAXH-XHAXHI

E çka thua për Muaviun?

SEIDI

Kam qenë i nxënë me vetveten e nuk kam pasur kohë t'i përcjell punët e të tjerëve e as të gjykoj për ta.

HAXH-XHAXHI

Po i shmangesh përgjigjes.

SEIDI

Lum ai që e preokupojnë të metat e tij e s'ka kohë për t'u marrë me të metat e të tjerëve.

HAXH-XHAXHI

E çka mendon për luftën midis Aliut dhe Muaviut?

SEIDI

Nga ky gjak All-llahu i pastroi duart tona, ndaj është mirë të mbeten të pastra edhe gjuhët tona.

HAXH-XHAXHI

Çka mendon për mua?

SEIDI

Ti e njeh veten më mirë se unë.

HAXH-XHAXHI

Por, unë dua ta di mendimin tënd.

SEIDI

Atëherë dije se të dëshpëron e nuk të gëzon.

HAXH-XHAXHI

S'ka gjë, dua ta di.

SEIDI

Më fal, më le të qetë.

HAXH-XHAXHI

Kurrsesi, All-llahu më faltë mua nëse ta fali ty.

SEIDI

Nëse është patjetër, atëherë po të tregoj se unë e di që ti e kundërshton Librin e All-llahut, Sunnetin e Pejgamberit alejhisselam dhe udhëzimet e Hulefai Rrashidinëve. E sheh veten në pozitë të lartë. Me sjelljet dhe veprimet tua dëshiron ta ruash dominimin tënd për ta forcuar pushtetin tënd. Kjo pa dyshim do të shkaktojë humbje, sepse dije se nesër do t'ï kthehesh All-llahut të Plotfuqishëm.

HAXH-XHAXHI

A nuk e kam dërguar ushtrinë që të luftojë në rrugë të All-llahut? A nuk e dërgova Muhammed bin Kasim Thekafiun që t'ï çlirojë banorët e Sindit? A nuk i forcova organet e sigurimit në krahinat e Irakut?

SEIDI

Gjithsesi, por ti je diktator dhe gjakderdhës, ndërsa Pejgamberi alejhisselam thotë: “Shkatërrimi i kësaj bote është më i lehtë për All-llahun se sa vrasja e një muslimani”. E si do të jetë halli për atë që ka vrarë me mijëra muslimanë? Ti o Haxh-xhaxh, dëshiron që robërit e All-llahut të bëhen robër tu, të të përkulen për të mirë e për të keq, kurse feja jonë lejon respektin vetëm për të mirë. Nuk respektohet krijesa kur i bëhet gjynah Krijuesit.

HAXH-XHAXHI

(Arsyetohet) A do t’i lëmë lakmuesit e pozitive të na copëtojnë? Kurrsesi, patjetër ne të drekojmë me ta, para se të darkojnë ata me ne.

SEIDI

Por feja e All-llahut nuk i lejon këto ushqime të neveritshme. Drekën e ha me këta e darkën me të tjerët. Sikur të kishe qëllim ahiretin, nuk do t’ia lartësoje vetes pozitën në pushtet. Nëse mbetesh sot, nesër do të shkosh patjetër.

(Te Haxh-xhaxhi vërehet skuqja e fytyrës, e frenon nervrikosjen dhe i jep bisedës kabe tjetër)

HAXH-XHAXHI

Unë jam më i dashur te All-llahu se ti.

SEIDI

All-llahu i di të fshehtat. Nesër çdo shpirt do të paguhet për atë që ka fituar dhe nuk dëmtohet aspak.

HAXH-XHAXHI

Unë jam me imamin e xhematit, e ti je me imamin e përçarjes dhe fitnes.

SEIDI

Xhemat quhet ai grup njerëzish që i përmbahen hakut, madje edhe nëse je i vetëm, siç ka thënë Ibni Mes'udi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, ndërsa fitne është keqtrajtimi i njerëzve në fenë e tyre.

HAXH-XHAXHI

A nuk sheh dobi që jemi tubuar rreth halifes?

SEIDI

Jo, nuk shoh dobi.

HAXH-XHAXHI

(Thërret një djalosh të pranishëm) O djalosh, bjeri arin, argjendin, margaritarët dhe rrobat e çmueshme.

(Djaloshi i sjell dhe i vendos para duarve të Haxh-xhaxhit)

HAXH-XHAXHI

Çka mund të thuash për këtë pasuri?

SEIDI

Ajo është e mirë dhe me vlerë nëse di ta çmosh.

HAXH-XHAXHI

E si mund të çmohet ajo?

SEIDI

Ta fitosh prej hallallit dhe t'ia gjesh vendin e vet. Të mos e ndrydhish atë nga nevojtarët e saj, se një trishtim Ditën e Kijametit çon gjidhënësen ta braktisë atë që e ka për gjini dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet.

HAXH-XHAXHI

A do të keshë diçka prej saj?

SEIDI

Nuk e dua atë që nuk e do All-llahu.

HAXH-XHAXHI

Ta lëmë këtë bisedë. Thonë se ti kurrë nuk je qeshur! Ku qëndron fshehtësia e kësaj?

SEIDI

Nuk kam parë gjë në jetë që të më bëjë të qeshem. E si të qeshet njeriu kur rruga e tij qëndron mbi xhehennem, nuk e di se a do të kalojë i shpëtuar apo do të bie i dënuar. “Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t’i afrohet atij (xhehennemit). Ky është vendim i kryer i Zotit tënd”.

HAXH-XHAXHI

E çka do të bëhet me ne që qeshim?

SEIDI

Nuk jemi zbutësit e zemrave. Çdo krijesë ka natyrën e vet.

HAXH-XHAXHI

A nuk ke dëgjuar ndonjëherë defin apo flautën?

SEIDI

Jam marrë me çështjen e ahiretit e i kam lënë anash muzikën dhe këngët.

HAXH-XHAXHI

Sillni defin dhe flautën!

(E sjellin flautën, njëri prej tyre fryen në të kurse Seidi qan)

HAXH-XHAXHI

Pse po qan, kjo është muzikë për argëtim.

SEIDI

Përkundrazi, është për dëshpërim dhe vajtim. Kjo flautë ma përkujton një rast të tmerrshëm. “Është dita që i fryhet surit, e ju vini grupe-grupe”. “Dhe i fryhet surit, kur ja, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre”.

HAXH-XHAXHI

A dëshiron të më mashtrosh me fjalë të buta që të të falë.

SEIDI

(Krenar) Kam nevojë për faljen e All-llahut, kurse ty s'kam nevojë të të arsyetohem e as të të kërkoj falje.

HAXH-XHAXHI

(I hidhëruar) Si dëshiron të vritesh? Zgjedhe një metodë?

SEIDI

(I vendosur) Zgjedhe ti për vete, se vall-llahi cilëndo mënyrë që do ta përdorish, po me të njëjtën ty do të të mbytë All-llahu në ahiret.

HAXH-XHAXHI

Pasha All-llahun, do të të vras me një mënyrë që askënd s'e kam vrarë më parë, e as që do ta vras pas.

SEIDI

Atëherë pra po ma shkatërron dynjanë time, e unë do ta shkatërroj ahiretin tënd.

HAXH-XHAXHI

O djalosh, shpatën dhe shtrojën e lëkurës!

(Djaloshi e sjell shpatën dhe shtrojën e lëkurës)

HAXH-XHAXHI

Kapeni!

(E kap djaloshi. Kur e kthen shpinën Seidi qesh, kurse roja i tregon Haxh-xhaxhit)

HAXH-XHAXHI

Ndal! A the se kurrë nuk ke qeshur. E tani pse qeshe?

SEIDI

Qeshem me kokëfortësinë tënde që e ke ndaj All-llahut dhe butësinë e Tij që e ka ndaj teje.

HAXH-XHAXHI

Mbyteni! Mbyteni këtë njeri.

SEIDI

(Kthehet kah Kibleja) “Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt dhe tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok”.

HAXH-XHAXHI

Kthene kah Kibleja e krishterëve të cilët u përçanë dhe u ndanë mes vete, se ky është prej ithtarëve të tyre.

SEIDI

(I buzëqeshur) “Të All-llahut janë Lindja dhe Perëndimi, dhe ngado që të ktheheni, aty është edhe ana e All-llahut”.

HAXH-XHAXHI

(I shtobet hidhërimi) Silleni fytyrën e tij, kthejani kah toka.

SEIDI

“Prej asaj (tokës) Ne ju krijuam dhe do t’ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t’ju nxjerrim edhe një herë”.

HAXH-XHAXHI

Preje armikun e All-llahut, gjuha e tij të mos flasë me Kur’an!

SEIDI

Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut, kurse Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. Merre këtë dëshmi prej meje o Haxh-xhaxh, derisa të takohemi Ditën e Kijametit. O All-llah, mos ia mundëso të mbysë askënd pas meje.

(PERDJA)

(AKTI I FUNDIT)

Haxh-xhaxhi duke fjetur në shtratin e tij në gjumë të thellë. Përnjëherë frikësohet dhe bërtet.

HAXH-XHAXHI

Më shpëtoni., më shpëtoni., më shpëtoni. Më lironi nga ky, ky dëshiron të më ngulfasë..
dëshiron të më mbysë.

(Hyn një djalosh)

DJALOSHI

Kush është imzot? S'ka askush këtu!

HAXH-XHAXHI

Ky është... është... S... S.... Seidi.

DJALOSHI

Seidi... cili është ai?

HAXH-XHAXHI

I mjeri ti, nuk e njeh! Seid bin Xhubejri. Më kapë për qafe, don të më mbysë.

DJALOSHI

Seidi është vrarë tashmë dy javë.

HAXH-XHAXHI

Ti je në mjegull. Ai është gjallë, nuk ka vdekur. Tash sa e pash, si devja e uritur... donte të më gëlltisë.

DJALOSHI

Këto janë pështjellime dhe shtirje ëndrrash. O zotëri, Seidi ka vdekur, është mbytur, ti e mbyte.

HAXH-XHAXHI

Jo... jo... unë nuk e kam mbytur... unë nuk e kam mbytur... ata e mbytën.

DJALOSHI

Ti apo ata, nuk është me rëndësi. Ai është mbytur, vdiq dhe është varrosur.

HAXH-XHAXHI

O ahmak! A do të më bindish për vdekjen e njeriut që ishte mbi kokën time para pak kohe, kurse duart e tij e shtrëngonin qafën time. Mjerë Haxh-xhaxhi, s'ka kush që i beson, madje as shërbëtori. Mbylle derën dhe më le vetëm.

(Del djaloshi dhe thotë)

DJALOSHI

Lavdia të qoftë o All-llah. Ngre kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Nëse Haxh-xhaxhi sot poshtërohet, kjo do të jetë argument për ekzistencën dhe drejtësinë Tënde o më i Drejti i të drejtëve.

(Haxh-xhaxhi shtrihet në shtrat dhe atë vetëm për disa çaste, kur i vjen në vesh ky zë)

“Zgjedh ti për vete, se vall-llahi cilëndo mënyrë që ta përdorish, po me të njëjtën ty do të të mbytë All-llahu në ahiret”.

(Haxh-xhaxhi tmerrohet për herë të dytë)

HAXH-XHAXHI

Ah... të lutem... të lutem... mos më mbyt... mos më mbyt... ah... ah....!!!

(Hyn djaloshti)

DJALOSHI

Ç’ke zotëri? Lirohu, mos u frikëso!

HAXH-XHAXHI

Si mos të frikësohem?! Hija e tij s’po më largohet. Ja ku është para meje. Ja ky, a nuk e sheh?

DJALOSHI

(Me zë të ulët) Çudi! Haxh-xhaxhi i cili frikësoi me mijëra njerëz, sot frikohet nga hija!

HAXH-XHAXHI

(E paska dëgjuar) Nuk është kjo hije, o i marrë. Ky është Seidi me asht e me rrasht. Ai ka vendosur të më mbysë.

DJALOSHI

Po pse gjithë kjo frikë nga vdekja!! Përderisa ti ke mbytur me mijëra e mijëra njerëz, shijo edhe ti sot atë që e shijuan njerëzit prej teje.

HAXH-XHAXHI

Po më fyen o i poshtër! Po që se shërohem do të bëjë copë-copë dhe do të mbetesh shembull për të tjerët.

DJALOSHI

Kryeneç je edhe në shtratin e vdekjes?! Bëhu i përlushëm para All-llahut së paku një moment para vdekjes. Por i mjeri ti... fjala e All-llahut është e vërtetë: “Prandaj edhe sikur të ktheheshin ata do të përsëritnin atë që e kishin të ndaluar, e s’ka dyshim, ata janë gënjeshtarë”.

(Haxh-xhaxhi bie nga shtrati)

HAXH-XHAXHI

Ah... çka kam unë me Seid bin Xhubejrin... ah çka kam unë me Seidin. *(I shtoben britmat, klith tmerrshëm dhe vdes)*

(Atëherë dëgjobet një zë i theksbëm)

“E ti kurrsesi mos e mendo All-llahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumçarët; Ai është duke i lënë ata deri në një ditë në të cilën sytë shtangen. (Atë ditë) ata të ngutur e duke i ngritur kokat lart, nuk i lëvizin sytë e tyre (për të shikuar), e zemrat e tyre janë të zbrazëta (nga frika)”.

(PERDJA)